



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS

Procesverbal i mbajtur më 28 maj 2021, në mbledhjen e XLIX (dyzet e nëntë) – e jashtëzakonshme, të Kuvendit të Komunës së Podujevës, mandati i VI.

E thirrur në kërkesë të 16 këshilltarëve të Kuvendit të Komunës, nr.prot.01-060/01-0040944/21 të datës 24 maj 2021,

Mbledhja filloi në orën 10;15 dhe u mbajt në sallën e mbledhjeve në objekt të Komunës.

Mbledhjen e kryesoi z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit të Komunës.

Në mbledhje të pranishëm ishin të gjithë këshilltarët/et e Kuvendit të Komunës, (Lista e nënshkrimeve).

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë dhe vendimmarrje.

Gjithashtu në mbledhje të pranishëm ishin edhe z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, znj.Marigona Lahu, Nënkryetare e Komunës, Drejtorët e Drejtorive (DA, DKRS, DBF, DPZHE DPKGJ, DSHPMSh, DBPZHR, DSHMS) të Komunës së Podujevës, përfaqësues të OJQ – DFK, përfaqësues të LMT KFOR – Podujevë, si dhe një numër i zyrtarëve komunal.

➤ Diskutim mbi gjendjen në arsim në Komunën e Podujevës

z.Fatmir Gashi, Kryesuesi i Kuvendit, e hapi mbledhjen duke i përshëndetur të pranishmit dhe duke iu dëshiruar punë të mbarë anëtarëve të Kuvendit. Në veçanti z.Blerim Maqastenës (i kthyer në Kosovë pas arrestimit të tij nga Policia e Serbisë) për të cilin theksoi, në emrin personal dhe të gjithë Kuvendit i urojmë shëndet të plotë dhe punë si gjithmonë aktive dhe në të mirë dhe interes të qytetarëve të Komunës së Podujevës.

Për këtë seancë të jashtëzakonshme sigurisht jeni të njoftuar me kohë, është thirr në kërkesë nr.prot. 01-060/01-0040944/21 të datës 24 maj 2021 të këshilltarit z.Adnan Zymeri dhe 15 këshilltarëve tjerë të Kuvendit të Komunës, duke caktuar edhe pikën e rendit të ditës ashtu siç përcaktohet me legjislacionin në fuqi, nenit 44 paragrafët 1 dhe 2 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale nr.03/L-040, nenit 6 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr.02/2015 për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, nenit 38 paragrafët 1 dhe 2 të Statutit të Komunës së Podujevës, nr.prot.01-020/01-0050862/19, dhe nenit 25.2 të Rregullores së Punës të Kuvendit të Komunës së Podujevës, nr.01/146-11 të datës 29 prill 2010.

Pra vazhdojmë me këtë mbledhje të XLIX (dyzet e nëntë), mandati i VI të Kuvendit të Komunës së Podujevës e cila është paraparë të mbahet me një pikë të vetme të rendit të ditës, dhe atë, diskutim mbi gjendjen në arsim në Komunën e Podujevës.

Kuorumi për punë ekziston andaj fjalën ia jap iniciuesit të kësaj thirrje të jashtëzakonshme z.Adnan Zymeri, urdhëroni fjala është për ju.

z.Adnan Zymeri, theksoi, fillimisht dëshiroj që t'i uroj mirëseardhje kolegut z.Blerim Maqastena duke i uruar shëndet dhe të mira pa fund dhe t'i them se na ke munguar gjatë kësaj periudhe ne

Kuvend. I nderuar Kryesues, i nderuar Kryetar, kolegë, media, qytetarë, shumë të nderuar nxënës, student dhe personel arsimorë, në zgjedhjet e nëntorit të vitit 2020, qytetarët votuan për një kauzë të proklamuar si ndryshim, që përfaqësohet nga njerëzit e njëjtë por të rreshtuar në një subjekt tjetër, kauzë e cila triumfoj, dhe Lidhja Demokratike e Kosovës me kulturën më të lartë politike bëri pranim-dorëzimin e udhëheqjes komunale, duke u bërë shembull në të gjithë vendin se si trashëgohen përgjegjësitë. Me të filluar qeverisjen, qytetarët filluan ta ndjejnë ndryshimin, së pari në Shëndetësi ku qytetarët shkonin për të kryer shërbimet e trajtoheshin me gjentilesë nga i pari i Komunës, pastaj ndryshimi preku edhe strukturën organizative të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare-QKMF-së duke emëruar asamblist në pozita menaxheriale. Ky ndryshim vazhdoj me Administratën duke e zhvendosur zyrën e subjektit politik që udhëheq me Komunën, në objektin e administratës komunale, normal ky transferim tash quhet nga Alo-Vetëvendosje në Alo-Komuna. Bash kur dikush nga qeverisja e ndryshimit tentoj ta bëj ndryshimin, ai për çudi dhe fatkeqësisht u gripoi, u deshtë të pushoj për rreth dy jave, pastaj arsyet pse i ka rënë gripi po i tregon çdo ditë në Facebook. Sikur u bë pak gjatë dhe humbi vëmendja ndaj qeverisjes së ndryshimit të madh, për ta rikthyer këtë vëmendje u përkujdes Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural që në mënyrë skandaloze dhe të jashtëligjshme pas rreth 5 muajsh anulon konkursin për motokultivator. Për të ardhur tek ajo për të cilën jemi mbledhur sot, për të diskutuar mbi gjendjen në arsim. Shfrytëzoj rastin t'i falënderoj të gjithë asamblistët nënshkrues dhe ata që kanë gatishmëri për kontribut gjatë kësaj seance.

Siç e dimë të gjithë, teknologjia e ka bërë shumë të lehtë jetën e secilit nga ne, por e ka bërë të lehtë edhe me pa kënd po e shpërblen pushteti. Mjafton një search në Facebook i emrave të përzgjedhurve në konkurset e Drejtorisë së Arsimit dhe shfaqen si rrufeja personat me foto të profilit “krejt dhe drejt”, ka raste kur edhe i mbyllin llogaritë por pak ka rëndësi, në Podujevë të gjithë njihemi.

Për më keq se kaq, ndodh që pa fije konkursi të prezantohen njerëz me petk partiak në vendin e punës duke u bërë hisedar të normës tënde veç pse t'i mendon ndryshe. Ndryshimi i madh nuk ndalët këtu, ai vazhdon me konkursin për drejtor ku përzgjedhja e drejtorëve bëhet e përgjysmuar ndoshta pse kapacitetet partiake janë të përgjysmuara por ndoshta edhe pse ka njerëz që ruajnë dinjitetin dhe nuk i binden këtij sistemi. Kulminantja e ditëve të fundit ishte, jo vendimi as njoftimi por Rekomandimi i komisionit për dhënien e bursave për nxënës dhe student, rekomandim i cili ia pamundëson kështu ankesën palës së dëmtuar, elemente këto që nga aspekti juridik do të shpjegohen nga dikush tjetër. Veç aspektit juridik në aspektin përmbajtësor në mënyrë ad-hoc, të pa bazuar, unike dhe tërësisht jashtë kriterëve të përcaktuara në konkurs, duke u bazuar vetëm në kriterin e ndjeshmërisë shpirtërore, shpresoj të mos jetë projektim elektoral, vendoset për ata përfitues të listuar. Për të mos u keqinterpretuar, unë shpreh konsideratën më të lartë njerëzore për personat me nevoja të veçanta, nxënës e student pa njërin prind dhe ata/ato me asistencë sociale, por këto kategori trajtohen nga dikastere të tjera të qeverisjes lokale dhe qendrore dhe në forma tjera, jo me bursë.

Në këtë proces gjen edhe përfitues nga e njëjta familje, presioni pastaj për tu larguar nga lista, duke ju kërkuar të japim deklarata që po tërhiqen në të kundërtën nuk do të mund të jenë më përfitues dhe akrobacione të ngjashme amatoreske.

Sikur mos të mjaftonte kjo, në sqarim thuhet se për shkak të buxhetit ka qenë e pamundur të ndahen bursa për më shumë student. Atëherë si ka qenë e mundur të ndahen 3 bursa për një familje. Arsyetimi për buxhetin bëhet edhe më i paqëndrueshëm kur hiç më larg se në seancën e kaluar tërhoqa vërejtjen se Drejtoria e Arsimit ka bërë bartje jashtë rregullave buxhetore për furnizim me kabinete të shkencave natyrore dhe informatikës, do të thotë mjete ka pas, por janë orientuar diku tjetër. Në atë seancë keni mund të bëni bartje për t'i subvencionuar me bursë aplikuesit në kohën kur po vazhdonin aplikimet dhe interesimi për bursa po shihej.

Për kabinete interesimin më të madh e kanë bursistët meritë të cilët ju nuk i shpërblyet. Për më tepër ju mund të thoni se numri i madh i aplikuesve është i pa përballueshëm për buxhetin, por vet e keni nxitë aplikimin e një numri kaq të madh se po të tregonit në fillim cilat kategori do t'i përzgjidhnit, të tjerët jashtë atyre kategorive nuk do të aplikonin fare, për atë vendosen kriteret.

Ju e keni ditë edhe sa buxhet keni të trashëguar nga qeverisja e kaluar para se ta hapnit konkursin. Viktimizimi nuk bënë punë, gjeni zgjidhje. Për studentët dhe nxënësit është ndryshim që nga 146,000.00€ mbështetje në vitin e kaluar, në 50.000.00€ për këtë vit, por është ndryshim i keq.

Sidoqoftë, LDK u rekomandon që: I nderuar Kryetar, me sinjeritetin me të madh po të lutem për nxënësit dhe studentët Llapjan, ju vetë jeni profesor dhe i dini vështirësitë me të cilat përballën ata, gjeni zgjidhje.

z.Rafet Llapashtica, përshëndeti të gjithë të pranishmit, e në veçanti z.Blerim Maqastena mirë se ke ardhë, theksoi, kjo seancë është e jashtëzakonshme për arsye se në vazhdimësi problemet me arsimin po vazhdojnë dhe politizimi dhe interesat edhe të Ekzekutivit edhe të drejtorit të DKA dhe disa asamblistëve që sorollaten neper zyrat e drejtorit duke u munduar të “kacavjerrën” dikund nuk po përfundojnë. Pasuria e një Kombi janë njerëzit e tij të arsimuar dhe të edukuar, të gjithë e dimë që nuk ka ndonjë të ardhme në shoqëri, e kjo nuk mund të arrihet në Komunën e Podujevës me ju drejtor z.Avni Fetahu dhe me Kryetarin z.Shpejtim Bulliqi i cili pranon që ju kështu të punoni, për arsye se kjo përgjegjësi e përfshinë edhe Kryetarin që i'u ka emëruar aty dhe në bazë të vendimeve që ke marr kjo tregon se t'i nuk ke kurrfarë kriteri të punës.

Përzgjedhja jo adekuate edhe politike edhe shokëve tu personal edhe të Kryetarit ka vazhdua edhe tash, në një të kaluar ke qenë me një Kryetar që ka vendos edhe nuk të ka pyet fare, tash ke ardhur me një tjetër që nuk di si do të merreni vesh duke iu bashku për një ndryshim të mirë sepse në atë kohë keni thënë nuk më lejon ish Kryetari z.Agim Veliu dhe tani po shkoj tek z.Shpejtim Bulliqi, dhe tani ky ndryshim është bërë që t'i mendon ta ndryshosh sepse ke thënë nuk po mund të bëjë me ata. I nderuari Kryesues dhe të nderuar asamblistë, në vazhdim po i përmendi disa raste konkrete e pastaj po e dëgjojmë drejtorin e DKA-së kur të dalë këtu në replikë nëse ka për të thënë diçka dhe ballafaqohemi me fakte pastaj, nuk duam të bëjmë debate pse jemi opozitë as pse jemi subjekt tjetër, por duam të ndihmojmë që arsimit të ecën përpara, shembull, qysh zotëri drejtor i DKA-së pranoi ju si profesor si drejtor i arsimit që e ke marrë këtë pozitë sepse ju jeni më i mençuri prej të gjithë profesorëve të Llapit për t'i drejtuar të gjitha shkollat të mesme fillore, para universitare, çerdhe publike, partneritet publiko privat që nuk ke fare, në shkollën “Naim Frashëri” ke emëruar një person me 180 kredi dhe ke eliminuar një me 330 kredi, e këtë që e ke emëruar është pa profil adekuat, i diplomuar në një kolegji privat, kurse ky tjetri është në Universitet të Prishtinës ka edhe Master dhe ka drejtimin adekuat për udhëheqje në arsim, nëse dëshiron me vazhdu me emra ne vazhdojmë, edhe në qoftë se i Vetëvendosjes është kur i plotëson këto kriteret duhet ta emërosh, gjithherë kam thënë që kur ke kuadër tendin duhet ta emërosh por kur nuk ke emëroje tjetrin nuk është me rendësi a është i LDK-së, PDK-së ose i Vetëvendosjes apo AAK-së, emëroje profesorin që i plotëson kriteret sepse ka për të hyrë në klasë, pra ne diskutojmë këtu ndërsa dikush është duke dhënë mësim atje.

Në shkollën “Enver Maloku”, i nderuar drejtor z.Avni Fetahu ju e dini shumë mirë që Ligji dhe Udhëzimi Administrativ që të obligon ty dhe gjithë neve këtu shumë strikt e specifikon që në udhëheqjeje nuk guxon të emërohet njeriu i cili është i emëruar politik 3 vitet e fundit, pra kush ta jep të drejtën ty drejtor të emërosh atë drejtor në shkollën “Enver Maloku”, një person i cili është kryetar nëndege i zgjedhur, ku e merr këtë të drejtë ti, nuk është problemi pse ai është atje se ai ka qëndruar drejtor deri tani dhe ashtu siç ka qen, por ti ardhur të ndryshosh, e ke manipuluar qytetarin se ne kur të vijmë kemi për t'ia bërë kështu e ashtu, përse nuk e ke hequr atë drejtor politik që ka qen

bashkë me ty i zgjedhur politik dhe pasi që ke shkuar në vetëvendosje me i tregu që unë ta tregoj vendin, cila është arsyeja pra, nëse je i interesuar hyjmë me emra, unë i kam me emra kush është eliminuar dhe kush është zgjedhur, por nuk po dua t'i përmend ata, ata e kanë punën e tyre, përgjegjësia është e jona këtu, e Kryetarit z.Shpejtim Bulliqi dhe e juaja z.Avni Fetahu që t'i rishikonin vendimet dhe t'i zbatoni ligjet sepse për atë keni abuzuar rrugëve dhe trotuareve që këta janë abuzues të ligjit dhe keqpërdorues dhe keni manipuluar me shpresën qytetare, me të varfërit dhe me të pasurit.

Në shkollën "Isa Boletini" ke punësuar njerëz pa konkurse, a e dini ju drejtor i DKA-së që në shkollën "Isa Boletini" ka punëtorë me 10 orë pune dhe ty kontrata kolektive dhe ligji përkatës (neni 14 pika 7) të obligon decidivisht që nëse ka profil të profesorit me gjysmë norme nuk guxon të punësosh punëtor të ri, as me konkurs madje e lëre pa konkurs siç ke vepruar t'i derisa ta plotësosh normën profesori të i mbajë 20 orë punë dhe mund të jetë mirë për atë që është punuar 30 vite, prandaj nga po vie ky ndryshim i juaji, këtë e keni bërë ju, nuk jemi fajtor ne opozita këtu sepse gjithçka ka lidhje me politiken, ngase po thoni vetëm pse jam opozitë po thua kështu, nuk është e vërtetë kjo, si guxon drejtori që e ke emëruar tani sepse vetë ju e keni emëruar dhe dërguar dhe ia ke dhënë 10 orë punë në bibliotekë, kurse drejtorin që e ke emëruar ka dy javë që sillet korridoreve, kush është ai drejtor që e mban çelësin në gjep dhe nuk ia jap punëtorit me hy në bibliotekë që t'i mbajt 8 orë punë, madje po edhe atë e ke dërguar në mënyrë jo të rregullt, mirëpo fundja e ke dërguar e ai e mban çelësin në gjep sepse dëshiron ta sjell vajzën e tij aty, unë e di se si punohet por nuk kam kompetencë të kryej detyra sikurse ti drejtor i DKA-së, ti je përgjegjës së bashku me Kryetarin z.Shpejtim Bulliqi dhe kjo është shumë e vërtetë, nuk po flas për ta degraduar, unë po e konstatoj gjendjen e gabuar kurse ti shko pyete punëtorin që e ke dërguar ku je dhe ku ke qenë këto dy javë, e nëse ja ka jap çelësin ai dhe nuk punon prapë edhe aty nuk është në rregull, nuk mund të thuash që nuk ja ka dhënë çelësin dhe është duke u sjellë korridoreve.

Pastaj dil këtu në foltore dhe trego edhe për degradimin me bursa, ju e dini çka dhe cili është vendimi dhe kujt i jepet bursës për shkollim, ju e keni ulur nivelin e nxënësit dhe studentit i cili refuzon nota 9 për të garuar në gara ndërkombëtare është student i 10-shës, ne kemi kërkuar këtu që të sjellëni dhe të miratojmë buxhet për shtresën sociale, le të del Kryetari z.Shpejtim Bulliqi dhe të thotë dua t'i subvencionoj 15 student dhe 15 nxënës që nuk kanë të ardhura, ne e kryejmë, por nuk mund t'i marrësh dhe të jesh më human se sa ne ashtu siç po mendon ti drejtor, dhe të kesh dhimbje më shumë për një familje që nuk ka të ardhura më shumë, cili është interesi i një studenti të marr nota 10 kur ju i japni bursë dikujt me nota 5-6 që ndoshta edhe e kanë humbur vitin. Cila është platforma jote ta zhvillosh arsimin në Komunën e Podujevës, nuk shkon kështu. Emrat që i ke kërkuar nga asamblistët që ti sjellin në zyre ty drejtor i DKA-së për bursa, ata emra të konkurrentëve shkojnë në komision, nuk ka me telefonata tek këshilltarët t'i shëtisni poshtë e lartë e të thoni unë bëjë ndryshime. Ju nëse doni të mbani kriter edhe Kryetarit tënd duhet t'i thoni unë kështu mendoj dhe nëse doni mirë, nëse jo unë eci në shtëpi dhe e përfundojë punën, me kënd të duash puno ti.

Pra ajo që e ceka është shumë e vërtetë, nëse doni jua tregoj edhe emrin kujt i keni thënë mi sjell emrat t'i jap 5-6 bursa. Unë nuk kam dalë këtu në foltore të bëjë shaka, nuk e kam thirr seancën unë edhe pse do ta kisha thirr, unë po flas shumë konkret, emrat shkojnë në komision, përndryshe mos ngrit komision merri aplikimet në gjep, vlerësoi vet dhe vendose listën vet. Cili drejtor i parë je ti që ne listë nuk lejon afat të ankesave me gjithë këtë punë të keqe që e ke bërë, me ato letra e duke u munduar t'i riformosh, duke bërë telefonata tek studentët tërhiquni ju që jeni nxënës e studenti i merr 400 e ju 200 tërhiq e ta lemë njërin sepse e kemi bërë punën jo mirë "berllog".

Sa shpenzime ke bërë ti drejtor i DKA-së, pastaj kush jeni ju që t'i urdhëroni drejtorët e shkollave të mos lëshojnë vërtetime për profesorët dhe personelin e shkollës për t'i gëzuar të drejtat e tyre që ia

lejon kontrata kolektive dhe ligji në fuqi, kontrata dhe ligje të cilat nuk i ka miratuar Kuvendi i Komunës së Podujevës por Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe ato ligje çka janë zbatuara dhe çka janë të aplikuara duhet t'i zbatojmë të gjithë ne, po e ceku këtë sepse po bëni zhurmë (po gargarisni) që nuk po zbatojmë Ligje ne PDK dhe po na cilësoni abuzues, kurse ti drejtor që ke shëtitur prej LDK-së në LVV nuk po e zbaton ligjin dhe tani del dhe na tregon përralla. Ti drejtor i thërret drejtorët e shkollave dhe i'u thua mos lësho vërtetim për një profesor që ta gëzon të drejtën e tij që ia lejon kontrata kolektive për shujta dhe për udhëtim. Ju duhet të kërkonit buxhet këtu në rishikim të buxhetit apo në fillim të vitit për t'i kryer obligimet ligjore që të obligon ligji, e them këtë ngase rreth 2 milion e gjysmë euro me LDK-në sa ke qenë të kanë shkuar suficit në Kuvend të Republikës së Kosovës, ndërsa i ke 1200 lëndë në gjykatë që janë për shumën prej rreth 420€ që ka për të dhënë ky kuvend dhe qytetarët kanë për t'i paguar, prandaj dil dhe tregoj qytetarëve, ky është një realitet dhe drejtori i DKA-së duhet të dalë sot këtu dhe të tregoj sa shkolla i ka nën kriterin 250 nxënës dhe sa drejtor të shkollave i ka të angazhuar me 10 orë punë, pra ligji është obligues e jo unë si Rafet ose ndonjëri prej neve këtu i PDK-së, LDK-së apo AAK-së.

Pra këto çështje që i ceka janë shumë të vërteta dhe për keqardhje, nuk është problemi se ne këtu po flasim, por problemi është jashtë mureve të kësaj seance, problemi është në shkollë, problemi është në qytet, problemi nuk zgjidhet kështu, problemi zgjidhet duke e vlerësuar njeriun dhe duke ia treguar karrigen e tij aty ku e meriton, e kështu nuk bëhet z.Avni Fetahu sepse ju jeni duke e vazhduar sistemin pikë-pikë të drejtorit të Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural duke telefonuar njerëz e me telefonata pa aplikuar fare, ndërsa për këtë çështje nuk po duam të jemi aq banal, por është dashur në shesh të mbahet kjo seancë e t'ju bëhej ftesë qytetarëve të shikojnë se çka ju bëni, me Kryetarin tënd që të lejon kështu të veprosh.

z.Hasan Ajeti, theksoi, realisht është temë e ndjeshme sepse besoi që kemi obligim moral dhe njerëzor që t'i mbështesim këtë kategori të veçantë të shoqërisë sonë, të jemi transparent kur flitet për student dhe nxënës gjykoj se duhet t'i tejkalojmë dallimet dhe përmasat politike, por jemi sot në këtë seancë të jashtëzakonshme për shkak të situatës së krijuar në arsim, respektivisht konkursit për bursa për student dhe nxënës e që për shkak të shkeljeve procedurale dhe materiale ka prodhuar një akt administrativ për të cilin nuk është domosdoshmëri me qenë jurist dhe të lexohet si akt administrative i pa ligjshëm. Është për tu habitur edhe qëndrimi i drejtorit të Drejtorisë së Arsimit që ka tentuar edhe me prononcim publik që veprimin në fjalë ta paraqet që është në pajtim me legjislacionin në fuqi.

Askush në këtë seancë nuk është kundër që të ndahen bursa kategorive sociale por gjithmonë duke respektuar kriteret dhe bazën ligjore për të cilën jeni obliguar që ta respektoni. Nuk keni të drejtë as ju drejtor i DKA-së por as edhe komisioni që t'i jap dikujt tjetër diçka përveç siç shprehimisht parashihet me dispozitat ligjore, në të kundërtën siç keni vepruar ju lexoheni me atë thënien e famshme tuajën "pazarxhi" apo dikush tenton që këtë rast ta kalkuloj nesër edhe për votë për asamble, por të jeni të sigurtë që është gabim. Jemi dëshmitarë se përveç shkeljeve të cilave i ceka më herët, përfitues të bursave janë më shumë se 10-15 raste ku ka nga një familje si për student ashtu edhe për nxënës. Pastaj është për të ardhur keq se si përjashtohen studentët e dalluar dhe kuadër universitar, rast konkret e ke rastit nga fshati Sfeçël që është student me notë mesatare 9.2 i Fakultetit të Mjekësisë dhe me gjendje të rëndë socio-ekonomike, rast për të cilin kam komunikuar personalisht me prindin e tij dhe sërish nuk e keni në këtë listë. Nuk është njerëzore të eliminohet një student i mjekësisë me notë mesatare 9.2 për arsye që realisht i dini vetëm ju, pra është pyetje legjitime për drejtorin e DKA-së sepse derisa LDK-ja ishte në pushtet ju keni goditur se niveli i arsimit është për të ardhur keq, në prononcimin publik e potencuat se një ndër shkaqet dhe arsyet pse nuk keni mundur të përfshihen të gjithë, ka qenë se një pjesë e madhe e studenteve kanë notën

mesatare mbi 8.0, do të thotë që lexohet se ka produktivitet, nuk është ajo gjendje siç është paraqitë. Pyetja legjitime është cila është arsyeja që në seancën e fundit në këtë Kuvend u miratua propozimi juaj që nga kategoria e të hyrave vetanake në vitin 2020 të barten afër 200,000.00€ në vitin 2021 dhe atë për infrastrukturë në kabinetet dhe në fusha të informatikës, çfarë motivi do të kenë sot dhe nesër studentët që vijnë nga fusha e mjekësisë, informatikës por edhe ata të fushave juridike dhe ekonomike për të cilët realisht kanë një notë mesatare mbi 8.0 deri në 9.0 e të cilët në mënyrë të kundërligjshme i përjashtoni prej një procesi sot, dhe pse jo është nesër. Programi juaj si Vetëvendosje që e keni pasur ka qenë dyfishim i fondit për ndarjen e bursave për nxënës dhe student, pajisje me kabinete për praktikë, por cili do të jetë efekti dhe rezultati në rast se ju sikur sot veproni edhe nesër si diskriminues, përjashtues dhe keqpërdorues të funksionit që ju e mbani.

Shumë të respektuar të pranishëm, këtu shihet qartë se ka shkelje dhe ka abuzim dhe keqpërdorim të detyrës zyrtare, ka element të pastër për vepra penale dhe nga ky vend i ftoj edhe organet që seriozisht të merren me këtë aspekt. Gjithashtu në programin e LVV-së ka qenë që rekrutimi i personelit arsimor do të bazohet në vlera profesionale dhe jo në vlera dhe baza partiake, në kohën kur kemi qenë opozitë, siç e thotë populli, “keni qenë ujk kurse tani jeni bere dele” në raport me abuzimet që ju atëherë i keni cilësuar si punësime partiake në arsim e që besa edhe me pankarta para komunës keni publikuar punësimet me element të nepotizmit dhe baza partiake.

Ta marrim vetëm konkursin e fundit dhe bindeni edhe ju vetë se jo që nuk është respektuar ky premtim elektorale dhe ligjor por shumica e të punësuarve janë militant dhe partizan të LVV-së, prej mësimdhënësve e deri tek punëtorët teknik, por përveç që keni marr militant politik ju nuk keni respektuar as parimet ligjore të konkursit publik ku jeni të obliguar të paraqitni listën e të gjithë aplikuesve në shpalljen publike për çdo pozitë veç e veç, por edhe për gjithë ata aplikues të cilët nuk i kanë plotësuar kushtet ose kriteret e konkursit.

Po ashtu shkeljet e juaj kanë vazhduar edhe në konkursin për drejtor dhe zëvendësdrejtor të shkollave të mesme dhe fillore, ju si institucion keni anuluar konkursin për drejtor me arsyetim se nuk janë respektuar afatet ligjore, pastaj keni shpallur për herë të dytë konkursin publik dhe realisht keni pasur të drejtë ligjore që në pajtim me nenin 8 nën paragrafin 2.6 të “*Udhëzimit Administrativ përkatës të MASH Nr.151/2020*” që ti vazhdoni procedurat edhe më me pak se 3 kandidatë edhe pse në disa shkolla si në fshatrat Metehi, Siboc, Herticë, referuar listës së kandidateve të publikuar me datë 24 mars 2021 ka pasur 3 deri në 4 kandidatë që i kanë plotësuar këto kushtet, dhe sërish i keni lenë pozitat vakante, përse nuk i keni zgjedhur drejtorët përderisa i keni ftuar në intervistë dhe ligjërisht të gjithë këta aplikues i kanë plotësuar kushtet sipas konkursit të datës 14 janar 2021, në të kundërtën ata apo ato nuk ishin ftuar në intervistë, apo arsyeja që 70% të shkollave kanë mbetur me ushtrues detyre është një dispozitë apo udhëzim që deri me 31 gusht të ushtrojnë detyrën e ushtruesit të detyrës e pastaj militantët e juaj t’i përmbushin ato kriteret të kalimit dhe të jenë pjesë e garës.

Në faqen e internetit të Komunës janë publikuar dy kontrata kornizë të ndara në dy lote, në lotin-1 është vlera 40,000.00€ ndërsa në lotin-2 është vlera 60,000.00€ që në total janë 100,000.00€, besoj që është mirë me qenë transparent edhe për publikun që të na njoftoni se çka nënkuptojnë me përshkrimin e këtyre 2 kontratave ku në të parën thuhet infrastrukturë shkollore por që nuk është vendosur asnjë paramasë në atë kontratë e që është obligim ligjor, kontratë e cila është publike në ueb-faqen e Komunës. Referuar këtyre 2 kontratave që janë me lote e që loti-1 hynë në fuqi prej 25.05.2021, kurse loti-2 prej 24.05.2021 dhe përfundon me datën sipas planit të proklamuar, pyetja ime është, nëse keni vullnet me u përgjigj, kush është caktuar menaxher i këtyre kontratave, në cilat shkolla veç e veç ka për t’u bërë përmirësimi i infrastrukturës shkollore, dhe tjetra a ka filluar implementimi i këtyre kontratave.

z.Ragip Fetahu, theksoi, na falni, me këtë frazë do duhej të fillonte fraza e parë e Grupit parlamentar të LDK-së, na falni, sepse 20 vite kemi menaxhuar me sistemin e arsimit, na falni, sepse 20 vite kemi degraduar, na falni, sepse 20 vite kemi punësuar drejtor politik, na falni, sepse kemi sjell arsimin në këtë gjendje këtu ku është, këtë do duhej ta bënte patjetër në vend se të thërrasin seancë të jashtëzakonshme për gjëra politike, kur e them këtë marr parasysh sepse seancë të jashtëzakonshme mund e thërrasin për kushtet në shkolla, mund të thërrasin për bullizmin, mund të thërrasin për dhunën në shkolla, mund të thërrasin për zëvendësimin e orëve të humbura gjatë periudhës së pandemisë por jo të thërrasin për gjëra të cilat janë të planifikuara. Drejtori në fjalë nuk prodhon para, nuk është fabrikë e prodhimit të parave, këto pra të cilat janë ndarë 50,000.00€ janë para të cilat janë ndarë nga ju të nderuar koleg, janë 50,000.00€ të cilat nuk mund të ndryshohen.

E di dhe e kuptoj që është periudhë zgjedhore sepse në muajin tetor janë zgjedhjet, mirëpo nuk do duhej të shfrytëzohen gjakrat e qytetarëve për interesa politike. E di që kemi nevojë për bursa, e di që kemi nevojë për stimulim për përkrahjen e nxënësve, por mos harroni një gjë, po e jap një shembull konkret, kur isha në shkollën e mesme kam udhëtuar nga një vend që është 30 km nga këtu, jam zgjuar në 04:30 të mëngjesit dhe kam ardhur në ora 08:00 në Gjimnaz, kam qene nxënësi më i mirë prej djemve në Gjimnaz dhe këtë e dinë profesorët, mirëpo në asnjë mënyrë asnjëherë Komuna nuk ka qenë afër meje për 4 vite, në asnjë mënyrë asnjëherë komuna nuk ka marr asnjë lloj përgjegjësie për mua se a me ngrënin ujë, a takoj llave të derrave, a më mbyty dikush a diçka rrugës, kështu që mendoj që përgjegjësia nuk është thjesht vetëm të thuhet, por edhe duhet të behet.

E di që vendimi të cilin e ka marr drejtori i DKA-së nuk është më i miri, mirëpo mos harroni që në konkurs të datës 09.02.2021 ndër të tjera thuhet që konkurruesit duhet të paraqesin dëshmi për gjendjen ekonomike dhe sociale si dhe nxënësit me gjendje të rendë ekonomike dhe shfrytëzues të asistencës sociale kanë prioritet, unë mendoj që duhet të jemi racional dhe real, e di që mund të bëjmë më shumë, e di që ka gabime, mirëpo unë jam i atij mendimi dhe e përkrahi atë mendim që arsimi nuk duhet të jetë i politizuar sikurse që ishte për 20 vite thuajse, kjo duhet të ndryshoj dhe kjo qasje besoi që me LVV-në do të ndryshoj dhe unë si asamblistë i LVV-së nga këtu i'u premtoj të gjithë atyre studenteve dhe atyre nxënësve që vitin që do të vije do të këtë kujdes shumë të shtuar dhe të paktën unë do të jem insistues që të ndryshohet buxheti për bursa për këtë kategori e cila janë e ardhmja e shoqërisë.

z.Pajtim Hodolli, theksoi, unë fillimisht dua t'ju tregoj që nuk dola këtu për të bërë politikë edhe pse është vendi për të bërë politikë, por jam jashtëzakonisht duke u ndjerë keq për veprimin që ka ndodhur. E di edhe gjendjen se si është komuna që nuk ka financa sa ka kërkesa, mirëpo këto pak financa që janë kanë mundur të sistemohen në mënyrë më të mirë, unë sot do t'i përmendi dy çështje për të cilat kam marr dhjetëra mesazhe nga nxënësit, studentët por edhe nga mësimdhënësit, mendoj që jemi ndoshta Komuna e parë e cila i vendos vet kriteret për subvencione ose për bursa dhe po vet nuk i përmbahet atyre kriterëve. Si është e mundur që një student ose një nxënës merr mundin të aplikoj dhe qëndron me shpresë mbi një muaj se a ka për ti dal apo jo bursë apo jo, fillon të bëjë planifikime për të blerë ndonjë libër, ndonjë laptop ose diçka të ngjashme, dhe në fund kur e shikon konkursin që është publikuar, kush ka fituar bursa e shikon që nuk i përmbush ato të cilat ai i ka synuar dhe të cilat kanë qenë me konkurs, me çka mendoj që ky konkurs është mirë të anulohet dhe është mirë që nëse unë po flas për votën time.

Nëse kërkon Komuna që me mbështet raste sociale me 10,000.00€ ose sa ka tjetër vlerë, unë do të jem i pari që do të votoj për, por jo konkursi që bëhet për bursa për studentë për të cilët po t'i vendosin kriteret të gjitha komunat dhe kjo çështje të shndërrohet në një diçka si rast social.

Po ashtu ajo çka është më e keqja të cilën më kanë thënë disa nga studentë që po ndihen të zhgënjyer e që edhe pse kanë fakte nuk ka as vend për ankesë, nuk kanë lënë hapësirë që të ketë ankesa, të

paktën 2-3 ditë të caktohen për të bërë ankesa dhe me i dëgju shqetësimet e nxënësve ose studenteve. Nuk po hyjë në atë sepse e cekën edhe parafolësit se a janë ndarë një familje më shumë ose më pak, a janë ndarë në një shkollë të caktuar më shumë e në një shkollë tjetër më pak, mirëpo mendoj që për raste sociale çdoherë që është kërkuar këtu, të paktën prej sa jam unë anëtar kemi votuar për, qoftë për ndarjen e mjeteve për covid dhe për të gjitha tjerat që ka pasë nevojë, edhe për shtëpia që janë ndërtuar herën e kaluar ku të gjithë kemi qenë për, prandaj nëse është nevoja për t'i jap mjete financiare dikujt për shkak se nuk i plotëson kushte, besoj që nuk ka asamblist këtu që do të votoj kundër për t'i subvencionuar rastet çoftë me nevoja të veçanta, çoftë për ata që nuk e kanë njërin prind apo kanë kushtet e vështira.

Një çështje tjetër që çdoherë kur po qëndroj me mësimdhënës të Komunës sonë po parashtrojnë pyetje është, përse nuk po e ngitni çështjen që Kryetari i Komunës gjatë fushatës ka dhënë një premtim, që të gjithë ata mësimdhënës që nuk kanë mundur t'i marrin parat për shujta të cilat i takojnë, në momentin që do të vij Kryetar i Komunës, do ta realizoj këtë. Jemi në dijeni se të gjitha shkollat janë në proces të kësaj duke angazhuar avokat me nga 10% e 15 % e duke paguar edhe nga 21€ shtesë për me mund me arritë një diçka e cila ju takon me ligj, andaj kisha pasë dëshirë të di prej Kryetarit se deri ku ka shkuar kjo procedurë dhe a janë mundësit çoftë tani çoftë me rishikim të buxhetit që t'iu realizohet një e drejtë që i'u takon mësimdhënësve, dhe të mos paguajnë ata avokat me nga 10% apo 15%, që i bie mbi 100€ për diçka e cila ju takon me ligj.

z.Avni Fetahu, drejtor i Drejtorisë së Arsimit-DKA, theksoi, me lejoni që fillimisht t'i uroj mirëseardhjeje anëtarit të Kuvendit z.Blerim Maqastena të cilit i uroj shëndet dhe ecje të mëtutjeshme në karrierën e tij të ardhshme. Fillimisht seanca e thirrur për arsim është bërë përkundër faktit se në seancë të rregullt ka qenë e paraparë plan programi për arsim, me theks të veçantë për bursa, shihet qartë se iniciuesit e kësaj seance dëshirojnë ta përdorin politikisht këtë seancë e që fundja është normale sepse për atë është edhe opozita, por një gjë shumë me rendësi që duhet ta di opinioni i gjerë e posaçërisht studentet dhe nxënësit është se pikërisht këta që kanë iniciuar këtë seancë të jashtëzakonshme kur kanë qenë në pozitë nuk kanë folur për arsim, sa që unë sa kam qenë shef i Grupit shumicën e herëve është dashur që edhe vet t'i marr t'i trajtoj temat e arsimit për arsye se hezitonin të flisnin për këtë, pikërisht për shkak të ndonjë hakmarrje të mundshme. Thirrja e kësaj seance dhe nënshkrues të një numri të asamblistëve që janë mësimdhënës do të thotë shumë pasi që ata nuk kanë nevojë të ndjehen të frikësuar si më parë, por mund të ngritin zërin e tyre për temat që i vlerësojnë që janë të arsyeshme për diskutim, të mos harrojmë se më herët një gjë e tillë shumë rrallë është realizuar, natyrisht nga frika e hakmarrjes, kurse ju opozitë e sotshme me theks të veçantë ish partia ime e cila për një vit ishte në pozitë për studentë që i ndau 146,400.00€ e njëjta për këtë vit zgjedhor i ka ndarë dhe planifikuar 50,000.00€, dhe tani kjo është një planifikim i çuditshëm kur t'i shumëzosh 146,400.00€, dhe duke pasë parasysh që shpenzimi është bazë për të planifikuar për vitin e ardhshëm, del si diçka që domethënë është lënë një farë bombe e kurdisur këtu me këtë shumë prej 50,000.00€, përkundër kërkesave të mëdha.

Lista e bursave, përkundër faktit që unë kërkoj mirëkuptim nga të gjithë studentët dhe nxënësit që nuk kemi pasur mundësi buxhetore me i përfshi të gjithë, ne jemi përcaktuar për ato kategori që tani më janë bërë temë, kategori të cilat ta keni parasysh nuk janë të dobët ashtu siç i parashihni ju, do të keni rastin secili nga ju të dilni dhe për secilin prej tyre vendoseni në prani të komisionit, tërhiqeni cilëndo, ose nëse doni shikoni rend më rend me numër do ta shiheni që ata studentë dhe ata nxënës për fat të mirë janë me nota të larta, dhe kur iu kanë shtuar edhe 20 pikë me asistencë sociale ose që nuk e kanë njërin prind normal që edhe në listë kanë dalë më lartë.

Të gjithë ju që po thoni që bursat janë vetëm për student dhe nxënës me arritje të larta, përse nuk vepruat vitin e kaluar t'i favorizoni këto kategori kur keni pasur buxhet goxha të mirë, unë kam

dëgjuar që ka pasur brenda Drejtorisë së Arsimit zëra të arsyeshëm që kanë thënë që meqenëse ka mjete buxhetore të mjaftueshme t'ua japim atyre me nota të larta, kurse këta që janë me nota të dobëta ta reduktojmë vlerën, por i'u keni jap të gjithëve njësoj, nuk është tamam që e keni pasur hallin aty. Sido që të jetë komisioni që ka qenë për ndarjen e bursave ka bërë disa lëshime teknike të pa qëllimta ku kanë dalë nga dy prej një familje si përfitues të bursës edhe sikur të kishte pasur ndonjë tendencë prej komisionit që ta favorizojnë ndonjë të tyre sigurisht që nuk kishin për të dalë ata emra, por qëllimi ka qenë në bazë të urdhrit exel-sofтверik kanë dal ato kategori, dhe ajo është gabim, nuk i kam zgjedh unë, komisioni e kanë kryer një punë të vështirë sepse kanë pasur 1818 aplikues para vetës, nuk e kanë pasur të lehtë të bëjnë këtë përzgjedhje. Është e rëndësishme të potencohet që ndërgjegjja është e pastër si nga komisioni për këtë çështje dhe interferime nga jashtë e nga brenda nuk janë lejuar, nëse ka dikush mund të dalë dhe të përmend emra, konkretisht të thotë që unë e kam thirr një asamblist dhe i kam thënë të mi jap 5 emra, ose ashtu e kështu si u cekë, pra është keq nëse mendon dikush që unë jam munduar që ta përdori politikisht këtë, nëse ashtu e vlerësoni ju, por nëse dëmtohet dikush më së shumti dëmtohet subjekti politik, normal për ndonjë veprim të caktuar edhe vet unë si Avni, por po të bëja kalkulime të tilla nuk i kishim zgjedh këto kategori.

Unë po ndjehem mirë që po ngritët zëri për arsim, këtë gjë kam bërë edhe sa isha në pozitë e opozitë mirëpo është mirë të jetë zëri i arsyes dhe i mundësive buxhetore që vetë ju e keni planifikuar, kur t'i vie radha e propozim buxhetit dhe ne të fillojmë së realizuari atëherë ka edhe arsyeshmëri për këtë pikë. Unë kërkoj mirëkuptimin edhe njëherë për të gjithë ata student e nxënës që një pjesë e konsiderueshme e tyre i kam pasur nxënës e student edhe sikur të bënim ndonjë kalkulim politik sigurisht që do të veprohej ndryshe, mirëpo rrethanat ekonomike sociale e pandemike dhe mundësit buxhetore nuk na kanë ofruar zgjedhje tjetër, ndërsa sa i përket disa pyetjeve që u parashtruan po mundohem të përgjigjem shkurtimisht.

Edhe unë e thash që ish qeverisja e kaluar ka dhënë shembull të lartë të dorëzimit të detyrës ku ai shembull të nderuar ka zgjatë më së shumti 5 minuta, prej kompjuterit të Kryetarit e deri tek kompjuterët e drejtorëve të drejtorive asnjë e dhënë nuk u gjend, çështje për të cilën ka deklarata me shkrim nga zyrtarët e IT-së që me urdhër të z.Nexhmi Rudarit janë fshirë të gjitha ato të dhëna, prandaj nëse e konsideroni shembull dorëzimit të kësaj detyre dhe me i fshirë të dhënat ajo është pa kuptim. Sa i përket kabineteve që pati pyetje, përse nuk i keni orientuar, ju e dini tani që kodet ekonomike si janë të dedikuara, nuk mund me i dediku kur na keni lënë borxh ju me ato kabinete e me i marr me i orientua në bursa, sepse po të ishte ndryshe me dëshirë i kishim orientuar, por janë kode ekonomike që nuk mund të ndryshohen.

Sa i përket çështjes së drejtorëve të shkollave, prej 42 pozita sa kanë qenë gjithsej, 37 drejtor dhe 5 zëvendës drejtor, 14 prej tyre janë kthyer në orë mësimore, shumica prej tyre me gjuhë shqipe, nuk kanë pasur çfarë t'i bëjnë me orë të gjuhës shqipe, i kanë bërë drejtor, a kështu bëhet drejtori a, ju pyes juve, dhe kjo ka krijuar vështirësi, megjithatë vullnet shumë i qartë ka qenë i Kryetarit që askujt mos me i'u bërë asnjë hakmarrje politike dhe të gjithë ata që janë në orë mësimore sot e kanë normën e plotë, pra as gjysmë norme nuk e kanë siç i keni dërgua ju më herët, 3 prej tyre kanë dal në pension, 8 pozita kanë marr mandatin e drejtorit dhe zëvendësdrejtorit, 29 prej tyre janë emëruar ushtrues detyre, dhe këtu shihen qartë se nuk mund të thoni ju që nuk ka pasur kuadër LVV-ja se nuk ka pasur këtë apo atë, nuk qëndron kjo për arsye se kriteret kanë qenë të qarta dhe sikur të kishte pasur dikush që i'u ka shkelur e drejta do të ishte ankuar por ne nuk kemi pasur ankesa në këtë proces. Prej të gjithë këtyre që i kemi zgjedhur vetëm 12 janë të rinjë, edhe këtu ka një ngritje tek gjinia femërore që në njëfarë forme ka qenë edhe premtim i Kryetarit të Komunës që me marr pozita udhëheqëse.

Sa i përket drejtorit të shkollës “Naim Frasheri”, kur do që dëshironi i nderuari asamblisti z.Rafet Llapashtica mund të vini dhe ta vërtetoni se është një prej kuadrove më të përgatitur në arsim me të gjitha përgatitjet, dhe nuk qëndron ajo që e potencuat se është me 180 kredi, fjala është për drejtor, kurse zëvendësdrejtor mund të them se është ushtrues detyre dhe si ushtrues detyre do t’i nënshtrohet tani konkursit, prandaj për drejtor nuk qëndron ajo që e potencuat.

Sa i përket shkollës “Enver Maloku”, në udhëzim administrativ qartë përcaktohet që ata kanë një deklaratë nën betim, a janë marr me politikë apo jo ne konsiderojmë që me këtë zgjedhje të drejtoreve kemi bërë një depolitizim, ata qartë shprehen që i dini edhe ju që nuk janë më vegël e askujt, as të Shpejtim Bulliqit e as e Avni Fetahut por punojnë lirshëm dhe janë duke ndjekur mirë punët dhe detyrat e tyre, mirëpo normale siç me thonit edhe mua që po qëndron vetëm në web-sid dhe po i shikon aktivitetet, aty shikoni edhe ju nga pak, nëse nuk mundeni t’i shikoni në web-side shikoni dhe shikoni punët në teren rreth përmirësimit të infrastrukturës në shkolla, mjafton me atë buxhet aq sa po kemi mundësi. Ndërsa sa i përket shkollës “Isa Boletini”, aty ka qen një kandidate e që po shihet qartë se ka dëshirë të merr informata rreth ndërlidhshmërisë dhe lidhshmëris me asamblistin që e kemi këtu, mirëpo ajo ka një përgatitjeje shkollore me matematikë informatikë dhe nuk mund të vijë në shprehje para atij që është me teknologji informative, në bazë të konkursit janë shpërndarë edhe ato orë dhe nuk ka pasur asgjë të keqe në këtë aspekt.

Sa i përket kontratës kolektive, ndoshta pajtohem me asamblistin që e ngriti këtë çështje, sepse nuk është dashur t’i thërrasim fare ata drejtor dhe t’iu themi lëshoni vërtetime sa të mundeni, por me i dërgu në prokurori të shtetit për arsye se ne nuk i kemi thënë mos aplikoni për kontrata kolektive ngase ajo çështje dihet botërisht, por meqë po detyrohem ta përmendi se me ardh prej një shkolle të qytetit në “Shaban Shala” me ish drejtorin e kaluar dhe me marr të njëjtën kompani dhe me ja vendos krejt nga 442€ që i kanë harxhuar udhëtim, kurse shumica prej tyre, rreth 80% banojnë në Podujevë, ata hiq fare nuk është dashur t’iu thuash lësho vërtetim, por është dashur t’ia dërgojmë lëndën në prokurori dhe me u marr prokuroria me ata persona për mashtrim, pra ju po jetoni në Podujevë dhe po i kërkon nga 442€ shpenzime të transportit, pastaj po i merr nga e njëjta kompani të goxha është njëfarë absurditeti.

Tek punësimet, është goxha e çuditshme i nderuari z.Hasan Ajeti, mua goxha do të me kishte ardhur turp sepse unë kam qenë një nga asamblistët dhe një aktivist politik që ndoshta kanë pësuar edhe familjarët e gjerë dhe të afërm që asnjë njeri të punësuar nuk e kam, kurse tani t’i përmendësh punësimet familjare ti, unë nuk po bie fare në atë nivel të të i përmend ty, por unë nuk kam punësime familjare. Sa i përket punësimit ne e kemi një parim shumë të qartë, ai parim është që ne jemi të interesuar që askush të mos jetë në pozitën që nuk e meriton, askush mos të marr një pozitë që nuk e meriton, por edhe mos të qëndroj jashtë pozitës së merituar, për arsye se keni lënë njerëz 17 vite me fakultet të Historisë pa i jap mundësinë të punojë kurrë, keni lënë njeriun 21 vite pa i jap mundësin të punoj kurrë, tani nëse kanë arritur të punësohen ata persona, edhe po të qëndrojnë në cilëndo parti politike ata kanë përparësi.

Sa i përket një projekti loto-1 dhe loto-2, vetëm sa është nënshkruar kontrata, ka të bëjë me përmirësimin e infrastrukturës fizike nëpër shkolla, çështje të cilën ju e keni lënë vërtetë shumë keq dhe të gjithë ato mjete që i keni orientuar në DDD për të shpërndarë ujë, që e kam përmendur shumë herë, ne i kemi orientuar aty ku duhet dhe do të përmirësohet infrastruktura fizike në aq buxhet sa kemi, përndryshe unë nuk po ndalem shumë dhe të tregoj se çka është realizuar në këto punë të Drejtorisë për arsye se ne e kemi edhe një seancë tjetër, mirëpo në kuadër të DKA-së kemi një plan të punës në bazë të të cilit punojmë. Ne jemi ballafaquar edhe me një varg problemesh të cilat i përmenda më herët, nga fshirja e të dhënave e tutje, kemi objektiva të qarta strategjike se nga mendojmë ta orientojmë si dhe kemi formuar një varg ekipesh funksionale të cilat i kanë munguar

DKA-së, dhe të cilat janë funksionale, kemi zyrtarët e arsimit që së paku secili prej tyre ka bërë 50 vizita nëpër shkolla e që zakonisht ata kane dalë vetëm nëpër situata tjera sa për ta bërë ndonjë gjest të caktuar, kurse sot dalin dhe e monitorojnë punën, kemi hartuar edhe një data bazë të të dhënave të cilën si model e kanë kërkuar prej nesh edhe një varg komunash tjera. Mandej jemi në vazhden e përmirësimit të infrastrukturës fizike, i kemi orientuar një varg kërkesash nëpër Ministri dhe organet relevante për përkrahje dhe jemi të hapur për çdo inspektim të mundshëm.

z.Hasan Ajeti, theksoi, zotëri Avni Fetahu, ne të kemi thirrë këtu dhe ke ardhur për temën që ka të bëjë me bursa për student dhe nxënës, në çoftë se tenton ta nxjerrësh argument që dje ka qenë keq dhe si pasoj që dje ka qenë keq sot po e trashëgon, do t'ju kisha thënë se për që ka qenë keq ka fituar LVV-ja dhe asnjë dyshim nuk ka. Në qoftë se u referohesh kriterëve, këto kriterë i ke vendosur vet, merre dhe shikoje listën studentëve të cilët janë përfitues të bursës, mandej më trego se ku ka të drejtë ankese. Unë mendoj që t'i edhe pse nuk je jurist por je ekonomist, këtë e dini, por të nxjerrësh konkluzë tani rreth numrit të përfituesëve, pa dashur të politizoj rastet sociale, ato janë një kategori që ju Kryetar pasi që jeni i fushës së arsimit besoj se e dini më mirë se unë, andaj të mos tentohet si e thotë populli “me na shitë dushk për gogla” për këtë punë sepse kjo shihet qartë. Tani po sa e shikova në web-faqe të Komunës se është publikuar listë e re, dhe shtroj pyetje sërish drejtorit të DKA-së, përse një student i fakultetit të mjekësisë nga fshati Sfeçël edhe pse rast social, sërish nuk është pjesë e listës. Sigurish jeni në dijeni shumë mirë që unë nuk jam kundër atyre të rinjve dhe të rejave, vetëm se kërkoj të respektohen kriteret.

Sa i përket asaj që u potencua rreth pranim dorëzimi, është shqetësuese sepse dy elemente janë të veprës penale, me veprim dhe mos veprim, andaj shtroj pyetje a keni bërë ju kallëzim penal për atë çështje, në qoftë se ka ndodh është shqetësuese dhe janë organet e akuzës për atë, e bënë kallëzimin penal dhe përfundon. Sa i përket viteve që po i përmend drejtori i DKA-së dhe po më drejtohet mua, ju rikujtoj se unë nuk kam qenë asnjëherë pjesë e Ekzekutivit, kurse ju zotëri Fetahu keni qenë, prandaj nuk mund të thuash aq lehtë se X personi paska qenë prej 2004 në ekonomi të tregut të lirë. Nuk jam as unë që të merremi me emra të përveçshëm për 17 vite, por për 2014-2018 sa kujtoj unë ti zotëri Avni Fetahu ke qenë pjesë e Ekzekutivit, pas kësaj ke qenë shef i Grupit të këshilltarëve të LDK-së, do të thotë nuk mund të thuash që nuk ke qenë, prandaj duhet ta pranoni qartë tani e jo me tendencë dhe tentime, sepse kjo është në kundërshtim me ligjin të jemi shumë të sigurtë këtu dhe nuk ka as çka të diskutohet më shumë. E potencuat se janë mbetur 50,000.00€ prej vitit të kaluar dhe nuk ka pasur më shumë mjete buxhetore sepse kështu janë mbetur nga koha e z.Nexhmi Rudarit, kurse në anën tjetër po thua e gjitha kjo është politike, në rregull po e marrim që është politizim e gjithë kjo, por ejani ju tani dhe mos bëni politizim, ju jeni thirr vet zotëri Fetahu në politizim, natyrisht nuk po të them vetëm ty sepse ka njerëz këtu që janë Bio-VV dhe dorën në zemër e dinë shumë më mirë se unë se çka.

Sa i përket punësimit dhe të akuzohem unë se kam familjarë të punësuar, në çoftë se ke dëgjuar me vëmendje askund nuk tu referova personalisht ty si Avni Fetahu sepse unë asgjë personale me ty nuk kam, mund ta kem politike por jo personale sepse kryhet seanca dhe mirupafshim nëse dëshiron flasim nëse jo nuk flasim ajo është temë tjetër por nuk e di që ke diçka personale me mua absolut, ndërsa të tentohet tani të paraqitet kjo listë ashtu e kështu, vet fakti që ka pasur shkelje në kemi ardhur në këtë situatë, vetëm merreni njoftimin dhe lexojë askund e gjeni që ka të drejtë ankese e që konsideroj se e drejta e ankesës është kategori ligjore dhe kushtetuese, kur të prodhohet vendimi duhet të shkruhet kush ka fituar bursë, NN personi, cila kategori ka të drejtë ankese, do të thotë këtu nuk është zotëri Avni, ne këtu mund të flasim deri në mëngjes. Është vendim i Qeverisë që studentët i ka liruar prej pagesave 100% në master dhe doktoraturë, është temë tjetër por qe besa edhe në mensën e studenteve kjo kategori që ju i'u referuat e ka një lehtësim, prandaj të thuret krejt kuptimi

që tani është trashëguar me keq politikë, nuk je bindës sepse nëse është keq unë them që ti ke fituar për të bërë mirë dhe eja rregulloje këtë apo atë, keni premtuar, keni thënë kemi me bërë ndryshime, mos të hyjmë për dikasteret tjera se ka mjaftueshëm.

Sa i përket drejtorëve të shkollave, unë e thashë që atë udhëzim që ju referoheni, është hera e dytë që është shpall konkursi, nuk po merrem me individ dhe nuk jam i thirrur unë të di se a i plotësojnë kriteret por në çoftë se ju zotëri Avni Fetahu ke thirrur për drejtor të shkollave në fshatin Siboc mbi 4 persona, Metehi 3 konkurrues, pastaj në Herticë, ata i nderuar duhet t'i plotësojnë kriteret, nëse nuk i kanë plotësuar kriteret qysh i keni marr në intervistë dhe nuk keni bërë zgjedhje fare, pastaj çështja tjetër që më është dukur jo logjike ka të bëjë me ushtrues detyre, po supozojmë prej një shkolle në fshatin Siboc e keni zhvendos në fshatin Obrancë, cilat janë arsyet, ose në fshatin Metehi a nuk është dashur të vazhdoj ai peron si ushtrues detyrë që ka qenë, edhe në Udhëzim rregullohet çështja kur nuk ka kuadër brenda institucionit, dhe e di që ke të drejtë të ndërrosh.

Sa i përket politizimit dhe nëse tani po t'i referohemi atij Udhëzimit 3 vitet e fundit një pjesë të madhe të drejtorëve i ke që nuk janë LDK, por ka të PDK-së, ka të VV-së, ka të AAK-së që janë në proces arsimor dhe ata kanë hyrë në punë në kohën kur ti zotëri Fetahu ke qenë drejtor jo i arsimit por i Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, pra janë mbi 7-8 fatmirësisht që janë pjesë e arsimit e të shëndetësisë, që kanë qenë në opozitë dhe kanë argumentuar keqpërdorimet-shkeljet që ata i kane lexuar, por askush nuk është marr me atë punë, kështu që në këtë temë gjykoj që nuk është mirë t'i japësh shumë karakter politik, mirëpo e ke momentin të mburrësh dhe të thoni kjo ose ajo është arsyeja, e kemi lexuar situatën kështu, kush është dalë është dal prej sistemit, përndryshe çka të vazhdoj humb sepse nuk ke argument për këtë temë.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, dëshiroj t'i ngrisë vetëm dy çështje, sa i përket shkollës “Naim Frashëri” është shumë e vërtetë për zëvendësdrejtor ka qenë aty jo për drejtorë se ndoshta e ke keqkuptuar dhe nuk ke arrit me dëgjua për shkak të teknikës, është e vërtetë që drejtori, ushtrues drejtori i zëvendësit është me 130 kredi dhe qëndroj prapa saj, është shumë e vërtetë që është me 130 kredi dhe nuk është me profil adekuat, shko merri letrat e konkurrentëve dhe shiko a janë shkelur të drejtat e njerëzve që i kanë plotësuar kriteret në shkollën “Naim Ferashëri” apo jo, unë po them janë shkelur të drejtat, ju si drejtor i DKA-së po insistoni se nuk janë shkelur, nëse nuk janë shkelur shko deri në zyrë, ne po të presim këtu, janë mediat këtu është edhe Kryetari i Komunës dhe sjelli emrat e konkurrentëve, sjelle dokumentacionin që ta kanë dorëzuar dhe sjelli letrat e atij ushtruesit që e keni caktuar ju, dhe jemi pastër, kjo është e gjithë çështja.

Çështja tjetra, sa i përket vërtetimeve që po thua (*i drejtohet drejtorit të DKA-së*) ka qenë mirë kështu e ashtu, ty nuk duhet t'ju interesojnë çështjet e tjera, një profesor i një shkolle në Podujevë ka të drejtë të posedoj dokumentin që është profesor i asaj shkolle, kurse ju për ti vendosur në rend pastaj ato çështje duhet t'i përfundosh ato detyra që i potencove, të shikoni nëse të ka bërë barrë buxhetore, dhe fundja t'i thoni tani ju tregoj unë se si manipuloni me mua, por për t'ia bërë ashtu goxha duhet me qenë shumë striktë në këtë çështje edhe fundja këtë punë edhe në fushatë Kryetarin zotëri Bulliqi unë kam dëgjuar në debat që i'u ka thënë ju (kundërshtarëve) nuk mund ta bëni sepse unë vije aty dhe merrem me kontratën kolektive sa i përket atyre suitave e udhëtimeve, madje ka thënë që për një javë e shikojë listën kush është kjo apo ajo, kjo është shumë e vërtetë dhe ka incizime për këtë punë, mirëpo nuk po dëshiroj ta infiltroj Kryetarin, mirëpo për barrën buxhetore të buxhetit mund të themi se është ndarë buxhet 4 herë prej kësaj salle këtu, kemi dalë shefat e Grupeve dhe ti drejtor ke insistuar që ky buxhet të jetë kështu për çka sigurisht jeni në dijeni shumë mirë, prandaj nuk mundesh tani këtu me u lirua nga përgjegjësia, qoftë për të kaluarën qoftë për të tanishmen sepse nuk guxon ta thirrësh një drejtor në atë formë, ose bëjeni menaxhim centralist dhe carist, ku duhet t'i thoni drejtorit të shkollës kështu e ashtu bëja.

A jeni në dijeni ju që shkolla duhet të këtë buxhetin e vet të pavarur, nga drejtori i DKA-së nuk duhet të varet një profesor doktor ose një magjistër i një profili të Gjimnazit e të Podujevës dhe të mos guxoj të bëjë e asgjë në atë shkollë dhe me ata nxënës. Kushdo që e bënë një gjë të tillë, nga cilido subjekt qoftë, nuk mund dhe nuk ka zhvillim të arsimit kështu duke pranuar telefonata një drejtor shkolle i cili është shkolluar 50 vite për atë punë dhe që është ekspert i fushës, formë kjo ashtu siç ka pritur dikur telefonata Rrahman Morina prej Beogradit me i thënë bëjë kështu apo ashtu, ku keni parë ju kështu i nderuar drejtor nëse ti je besimtar dhe thirrëmi në besim, nëse je besnik e transparent e mban fjalën dhe qëndron prapa atij qëndrimi, po është shumë e vërtetë që i ke thirr drejtoret e shkollave dhe për këtë dil dhe thuaj, i kam telefonuar Rafet për këtë sepse nuk kam ditur çfarë të bëjë dhe i kam thirr i'u kam thënë mos lëshoni vërtetime. Pra si ka të drejt, shembull, një punëtori të administratës tani t'i ndalohej nga Kryetari z.Shpejtim Bulliqi të lëshoj vërtetim që je punëtor komune ose Kryesuesi i Kuvendit të mos lëshoj një dokument që ne jemi asamblistë të Komunës së Podujevës, ku guxon të ndodh kjo, unë këto gjera desha ti sqaroi.

Ne e kemi thirr këtë seancë, por jo të dëgjuar çka ka bërë LDK-ja as çka ka për të bërë dikush tjetër ashtu siç e tha z.Ragip Fetahu kur të vij unë ju garantoj..., mirëpo unë i them atij që as unë as ju nuk e dimë në tjetrin mandat a zgjedhemi apo jo se qytetari me votë na tregon, të mos keqkuptohemi, ne garantojmë vetëm për këtë mandat që jemi këtu sepse nuk e dimë dhe nuk kemi garancë që do të jemi sërish, pra garancë mund të japim vetëm për periudhën sa jemi këtu me mandat, qoftë nga Ekzekutivi qoftë nga Kuvendi.

Çështja tjetër, ka shkelje sepse nuk ke emëruar komision të ankesave dhe nuk ke lënë hapësirë për askënd që të bëjë ankesë, këtu është problemi, pra ju në momentin e shpalljes së konkursit duhet ta keni të ngritur komisionin vlerësues dhe komisionin e ankesave, afatin e ankesave dhe ta potenconi se a ke shpall konkurs për subvencionim për raste sociale apo për shkencë, prandaj këto janë gjërat që për arsim po flas, ne nuk jemi duke debatuar për raste sociale, përndryshe e thërrasim një seancë për raste sociale dhe i përfundojmë ato të gjitha që na paraqiten, mund ta rishikojmë gjithë buxhetin në muajin qershor, 50-100 student le t'i propozon Kryetari, le ta bëjë komisionin prej Kuvendi dhe Ekzekutivi, dalim në çdo fshat dhe lagje të qytetit, i gjejmë kush janë rastet sociale dhe ua japim 200€, dhe besoj që 300,000.00€ apo 500,000.00€ ka buxhet Komuna, sepse ska propozime të Kryetarit pa marrë miratim në Kuvendit, ose të bëhen lojëra duke vendos 10,000.00€ / 5,000.00€ vetëm ashtu. Prandaj nëse ka raste sociale e që e di se ka, po i kryejmë, por këtu po duam të shesim burrin të gjithë, është duke u bërë lufta kujt po i dhimbset më shumë ty si VV apo neve si PDK, a po i dhimbset fukaraja dikujt apo jo. Ose hajde po e bëjmë një fond solid komunal e institucional dhe t'i japim nga 10€ për 20 studentë, mirëpo nuk ka propozim këtu për rastet sociale këtu, çështja po mbetet ai që foli i fundit ai e jep versionin e tij dhe po kamuflohet dhe po ecën puna, kurse ti (i drejtohet drejtorit të DKA-së) as nuk ke bërë zgjidhje, dhe në këtë aspekt unë flas gjithëherë për karrigen/pozitën jo për zotëri Avnin, prandaj mos e merr personale, mirëpo edhe njëherë e përsërisë që as nuk i ke bërë zgjidhje rastit social as nuk i ke bërë zgjedhje studentit i cili ka për tu bërë shkencëtar, sepse i ke eliminuar dhe bastarduar të gjithë, të gjithë i ke bastarduar.

z.Adnan Zymeri, theksoi, i nderuar drejtor z.Avni Fetahu, ju më herët thatë që nuk e vlerësoj si veprim të mirë pranim dorëzimin e detyrës që është bërë, por ju jo që bëni pranim dorëzime por ikni komplet prej zyrës, ju edhe dokumentet zakonisht i kërkonin nëpër tavane, dollapë, mirëpo dokumentet janë të arkivuara dhe protokolluara edhe kjo besoj që është në rregull.

Sa i përket fshirjes së të dhënave prej kompjuterit po me tregojnë këtu që edhe t'i ishte pas habit i ke fshirë sa ke qenë drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural kur e ke dorëzuar detyrën.

z.Agron Hyseni, theksoi, vetëm deshta një sqarim për drejtorin e Drejtorisë së Arsimit sa i përket udhëzimit për nënshkrimin e seancë së jashtëzakonshme, ka këshilltarë këtu që janë mësimdhënës dhe që kanë qenë mësimdhënës, që gjatë kohës sa kanë qenë në pozitë kanë nënshkruar thirrjen për seancë të jashtëzakonshme atëherë kur ka qenë e nevojshme dhe e arsyeshme kërkesa e opozitës.

z.Ragip Fetahu, theksoi, ekzistojnë në Gjuhe Shqipe disa fjalë që ata që janë ligjërues të Gjuhës Shqipe e dinë besoj, pra quhen përemrat pyetës; kush, çka, si, pse, ku edhe kur. Këta përemra mendoj që janë shumë të rëndësishëm që koleget e mi asamblistë t'i përdorin, edhe ti bëjnë pyetje vetës kush jam unë, pse po e bëjë, çka po bëjë, ku edhe kur po e bëjë.

z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, theksoi, fillimisht më lejoni t'i uroj kolegut këshilltarit të Kuvendit z.Blerim Maqastena kthimin nga një vend të cilin praktikisht nuk do të ia dëshironim askujt por falë zotit është kthyer mirë, i është kthyer familjes dhe i dëshirojmë shëndet dhe suksese në punën e tij.

Mendova të marrë apo jo fjalën për arsye se mendoj që drejtori i Drejtorisë së Arsimit i tha gjitha ato që u dashtë me i thënë. Ne e kemi shpallë një konkurs për bursa për studentë dhe nxënës me një shumë mjetesh prej 50,000.00€ të cilat janë dedikua sipas buxhetit për vitin 2021, gjë që praktika e tregoj që ky buxhet i vitit 2021 ka qenë dyfish më i vogël se sa buxheti i planifikuar për vitin 2020 sa ka qenë mbi 140,000.00€ kur ishte shpallë një konkurs i tillë. A ka pas vend që ato kritere të analizohen më mirë, unë them që po edhe po të ishin analizuar më mirë ato kritere dhe në një formë ato kritere me u mbështet me ato mundësi buxhetore që i kemi, them që nuk do të lindnin këto fjalime dhe këto diskutime sepse unë besoj shumë që as ne si LVV nuk jemi më patriotë edhe më të interesuar t'iu ndihmojmë atyre nxënësve dhe studentëve ashtu sikurse që as ju nga subjektet tjera nuk mund të jeni më të ndjeshëm në këtë aspekt. Ata janë fëmijë tanë, janë fëmijë t'juaj, dhe të gjithë jemi të interesuar t'ju ndihmojmë me ato mundësi që kemi.

Tani meqenëse nuk është bërë në fillim mirë dhe ka pasur lëshime në ato kritere, normale që Drejtoria e Arsimit erdhi në një situatë që me atë shumë buxhetore që kishim të planifikuara do të mund të vepronim sigurisht siç keni vepruar vitin e kaluar dhe t'iu japim nga 20€ bursë ose nxënësve ose studentëve e që mendoj se kishte për të dalë qesharake dhe besoj që të gjithë do të na kritikojnë.

Ju e keni pasur një fat të mirë që i keni pasur mbi 180,000.00€ të planifikuara, kurse ne patëm fatin e tillë që i patëm vetëm 50,000.00€ të planifikuara për vitin 2021 dhe erdhëm këtu ku jemi.

Duke pas parasysh nevojën e madhe të fëmijëve bonjak (jetim), fëmijëve të cilët janë me gjendje të rendë sociale dhe fëmijëve me nevoja të veçanta në aspektin fizik, atëherë komisioni përkatës rekomandoi që për ta mbyllë këtë proces pa ndonjë telashe të madhe, të bëhet një veprim i tillë çfarë është bërë dhe kriteret bazë të jenë këto. Në bazë të këtyre kriterëve dhe punës që ishte bërë nga ana e komisionit përkatës, është e vërtetë që kanë rrjedhë disa gabime, gabime të cilat disa nga to janë të arsyeshme dhe disa të pa arsyeshme, mirëpo të jeni shumë të bindur që në ato aplikacione ka pasur edhe ndërrim të emrit të prindit (prej emrit Sahit në Sabit) dhe gjëra tjera rreth vendbanimit dhe të ngjashme sepse nganjëherë edhe gjëra të tilla dinë të ndodhin prandaj edhe kanë rrjedhë edhe gabime, mirëpo sot, nëse keni mundësi të qaseni në faqe zyrtare do të shihni që kanë dalë lista të reja të plotësuar dhe përmirësuar, përveç asaj shume buxhetore, është shtuar edhe një shumë e vogël buxhetore me qëllim të mbulimit të të gjitha atyre rasteve të fëmijëve jetim, rasteve sociale dhe atyre me aftësi të kufizuara dhe janë nxjerrë këto lista të cilat tashme janë publike si dhe ajo që është më e rëndësishme mund ta vëreni se është dhënë edhe e drejta e ankesës. Ne kemi komisionin për ankesa dhe në rast se paraqitet nevoja dhe ankesa nga ndokush që nuk është përfitues i bursës, ne sigurisht që do të analizohen me kujdes.

Se a i kemi plotësuar nevojat e atyre nxënësve dhe studenteve, e them se jo, a është dashur të caktohen drejtime prioritare në konkurs, mendoj që po, pastaj se a është dashur që disa drejtime që

janë me prioritet më të lartë dhe për të cilat kemi numër më të vogël të studenteve besoj që kjo do të na lehtësonte shumë, mirëpo ta keni parasysh meqë vitin e kaluar i'u janë dhënë bursa të gjithë studenteve dhe nxënësve që kanë aplikuar, normale që në këtë vitë ka pasur një dukuri që të gjithë kanë insistuar të aplikojnë duke shpresuar që ndoshta edhe këtë vit do të ndahen për të gjithë, dhe kjo në një formë e ka nxitë numrin e madh të aplikacioneve.

Unë po i'u them që ne nuk jemi kurrë vonë, e dimë që ata student dhe nxënës kanë nevojë për një shumë të mjeteve buxhetore, qoftë edhe simbolike, dhe nëse dakordohemi tani, ne me rishikim të buxhetit të buxhetit mund të shikojmë mundësitë financiare dhe të ndajmë një shumë buxhetore shtesë ku pastaj mund të hapim edhe një konkurs të ri për bursa në mënyrë që t'u ndihmojmë atyre nxënësve dhe studentëve. Pra besoj që si Ekzekutiv por edhe nga ana e subjektit politik ne jemi të gatshëm po që se gjejmë një pozicion buxhetor ku mund të kursejmë buxhet, e që besoj që ka shumë kursime në shumë sektor dhe mund të ndajmë një shumë të re buxhetore dhe pas 1 ose 2 muaji të rishikimit të buxhetit të mund ta shpallim një konkurs të ri dhe të ndajmë bursa, ku po ashtu do të mund të përcaktojmë qartë dhe mirë kriteret, prandaj e them sepse nevojat për t'ju ndihmuar janë të mëdha dhe që mund t'i marrim për bazë të gjithë ata studentë dhe nxënës duke marrë për bazë edhe notën mesatare të tyre apo profilet e tyre.

Sigurisht jeni në dijeni shumë mirë që unë jam prej atyre që kam pasur provojë relativisht të gjatë në fushën e arsimit, dhe jeni në dijeni që arsimi është fushë shumë gjerë dhe gjithmonë ka qenë kështu, madje në kohën e kaluar sa isha pjesë e organeve komunale këtu për dy mandate, nuk ka pasur seancë të Kuvendit që nuk është diskutuar për arsimin ku disa këshilltarë të caktuar të Kuvendit në një formë kanë qenë kujdestarë për arsim dhe në çdo seancë të Kuvendit është diskutuar, prandaj konsideroj se edhe tani ka mundësi dhe nevojë të diskutohet dhe të thuhet gjera të mira por ka mundësi të ketë edhe lëshime në punën që bëhet në këtë sektor sepse është një sektor i madh dhe me goxha shumë probleme për të cilat unë po besoj që administrata komunale por edhe Drejtoria e Arsimit po kujdesen që t'i mënjanojnë.

Çështja tjetër, ju e dini shumë mirë që është më se e vërtetë që kemi diskutuar edhe për shujta edhe për kompensime që i'u takojnë punëtorëve të arsimit, po ju tregoj dhe besoj që jeni në dijeni edhe ju që janë rreth 2 milion euro borxhe për sektorin e arsimit dhe shëndetësisë në Komunën e Podujevës, borxhe këto në kuptimin e shujtës dhe pagave jubilarë atyre të cilëve ju takojnë në bazë të kontratës kolektive, borxhe të cilat nuk i kemi krijuar ne sepse ne i kemi vetëm 6 muaj prej se kemi ardhur në qeverisje të Komunës, pra i kemi gjetur, prandaj nëse ky Kuvend sheh ndonjë mundësi buxhetore që mund t'i ndajmë rreth 2 milion euro, natyrisht që ne si subjekt politik qëndrojmë mbrapa dhe e përkrahim, vetëm urdhëroni gjeni mundësitë dhe si kryetar i Komunës do të jemi shumë i kënaqur, ndoshta prej më të kënaqurve për t'ju kompenzuar borxhet që i kemi. E potencoj edhe drejtori i Drejtorisë së Arsimit se është për keqardhje që shumë prej atyre padive që janë bërë ndoshta nuk janë meritore, unë vetëm po ju tregoj një shembull, janë me qindra mësimdhënës të cilët jetojnë në qytet këtu në Podujevë dhe të cilët komplet padinë e tyre e kanë bazuar me një biletë të autobusit, me të njëjtën biletë apo kupon fiskal, me të njëjtën shifër të atij kuponi fiskal, që do të thotë se vetëm një biletë është marrë 0.50 cent dhe ajo biletë nuk është e Podujevës, por është e relacionit Podujevë-Prishtinë dhe të njëjtën e kanë futur në padinë e paraqitur në Gjykatë në kuptim të kërkesës për kompensim, e që për mendimin tim është veprë penale nëse shikohet dhe hetohet sepse është i njëjti kupon me të njëjtat shifra që e kanë dërguar së bashku me padinë e bërë.

Nuk është vetëm Komuna e Podujevës që nuk mund t'i kryhen këto borxhe, pothuajse të gjitha komunat në nivel vendi e kanë të njëjtin problem me përjashtim të disa komunave të vogla që kanë arritur pak a shumë t'i paguan këto borxhe, mirëpo të shikojmë shpejt do të vie edhe projekt buxheti i Komunës për vitin 2022, ulemi së bashku edhe me asamblistë të cilitdo subjekt politik e diskutojmë

dhe gjejmë formën dhe mënyrën që t'i ndajmë 2 milion euro, borxh të cilin unë do të isha shumë i kënaqur nëse arrijmë ta përfundojmë sepse janë dokumente të cilat nuk janë nënshkruar nga komuna por nga një nivel tjetër që është Ministria realisht Qeveria e Kosovës e që është dashur ta marrin përgjegjësinë dhe të ndajnë fond shtesë për t'i paguar këto borxhe. Në këtë aspekt sigurisht jeni në dijeni që me përjashtimin ndoshta Komuna e Prishtinës e cila ka të hyra të mëdha, asnjë komunë tjetër nivel vendi nuk ka mundësi që vetëm me buxhet të vetin të përballojë këtë kompensim, prandaj e them që ne mund të diskutojmë dhe të japim premtime por në realitet e kemi vështirë me realizu. Se a do të ishte mirë që të fillojmë diçka në këtë drejtim mendoj që po, madje unë mendoj që në projekt buxhetin e vitit 2022 Komuna e Podujevës duhet ta këtë një fond-shumë buxhetore cilado qoftë ajo që të fillohet me një qasje ngase për çdo padi dhe ankesë që bëjnë punëtorët e arsimit Komuna do të ngarkohet edhe me shumën e përqindjes që e marrin nëpërmes avokatit dhe atyre lëndëve që i trajtojnë me tutje, prandaj jemi të interesuar të bëjmë zgjidhje, kërkojmë ndihmën e gjithë juve sepse ajo është e nevojshme dhe e domosdoshme për me mund me i tejkalua këto probleme që janë.

z.Hasan Ajeti, theksoi, i nderuari kryetar këtu është prodhuar një vendim, dhe ky vendim specifikon se vendimi ka qenë i kundërligjshëm dhe nuk kemi çka e diskutojmë më për asnjë argument për këtë pikë. Çështja tjetër, është bërë plotësimi ndryshimi i listës që ka dalë në faqe zyrtare sot gjatë kësaj seance të cilin unë tani e shikova dhe asnjë prej nesh nuk kemi mund ta shikojmë, por fundja si opozitë nuk është çështje imja por e Drejtorive dhe organeve përkatëse që ju i menaxhoni. Në momentin që tenton me nxjerr argument që ka qenë në rregull kjo, vet formati i vendimit, e përsërisë se është skandaloz, ja ku e ke drejtorin e Drejtorisë së Administratës i cili i dinë se si janë elementet e një vendimi si bazë ligjore për tu hartuar një akt.

Çështja tjetër, u përmenden 2 milion euro si vlerë, ato obligime dalin sipas kontratës kolektive, këto janë për çdo organizatë buxhetore në territorin e Kosovës, nuk janë vetëm për Komunën e Podujevës. Më herët kolegu z.Ragip Fetahu tha se gjendja në arsim vije që 20 vite si pasojë e qeverisjes së kaluar të LDK-së, mirëpo unë nuk kam qenë drejtor i arsimit para 20 viteve por ka qenë pikërisht Kryetari aktual i Komunës, e atëherë ju e dini a keni qenë me kontratë apo pa kontratë, ju keni qenë drejtor i Drejtorisë së Arsimit në çoftë se thuhet krejt është zi atëherë del në kundërshtim me atë që tha më herët z.Avni Fetahu se ka pasur një numër të madh studentësh që e kanë notën mesatare mbi 8.0, që nënkupton që janë student të mirë në fusha të ndryshme, prandaj po dilni kontradiktor në argumentim. Unë nuk hyj në atë fushë ku nuk kam njohuri, kurse në çoftë se dëshiron dikush të bëhet protagonist është temë tjetër, mirëpo sa i përket kësaj se për çka realisht kemi ardhur në këtu, të jemi shumë të sigurtë çdo tendencë që të jepet argument tjetër, qasje është gabim. Për vitet e kaluara, unë e thash edhe njëherë që janë procese politike për atë janë zgjedhjet në çoftë se shkon edhe ju kështu në muajin tetor edhe ju duhet të lëshoni vend dhe të vije një tjetër sepse këto janë procese, mirëpo as nesër ai që vie nuk mund të thirret në të kaluarën, jo na keni lënë 20,000.00€, jo në kohen e juaj keni bërë ashtu e kështu. Ju z.Avni Fetahu e din shumë mirë si ka shkuar ajo punë (*rreth zbatimit të kontratës kolektive*), mirëpo po dua të them edhe njëherë edhe sa i përket temës rreth një bilete që e ceku Kryetari i Komunës për një numër të stafit arsimor, për atë çështje mund të këtë elemente të veprës penale dhe në çoftë se ka elemente të veprës penale, absolut nuk guxon askush të ndërhyjë. Edhe njëherë sa i përket bursave, tani unë po ju jap si rast në çoftë se thoni nuk është argument dhe nuk e keni përjashtuar, unë po e ndërlidhi personal dhe po e shfrytëzoj politikisht për studentët me notën mesatare 9.2 në fakultetin e mjekësisë.

Për që ka qenë keq dje, për atë jeni ju këtu sot, por mos e nxjerrin si argument këtë, unë nuk po hyj me emra, ne nuk po ju themi të merrni me emra sepse askush nuk është kundër atyre kategorive absolut dhe nuk besoj që ka njeri këtu që thotë jam kundër kësaj kategorie.

z.Adnan Zymeri, theksoi, unë si iniciues i seancës në bashkëpunim me LDK-në rekomandojmë përmes kësaj seancë që të gjithë aplikantët, studentët dhe nxënësit që kanë aplikuar në këtë konkurs dhe që i plotësojnë kriteret në bazë të këtij konkursi të jenë përfitues të bursave. Këtu po diskutohet edhe për çështjen financiare, Kuvendi nuk është ai që i tregon Ekzekutivit se ku t'i merr paratë, por është Ekzekutivi i Komunës, konkretisht drejtori i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave -DBF-së ai që duhet t'i shohë hapësirat dhe të respektojë vendimin e Kuvendit, do të thotë neve si Kuvend na takon që tani të marrim vendim, ndërsa hapësirë ka për shkak se jemi konsultuar me ekspertet e çështjeve financiare dhe e dimë saktë se ku mund të merren paratë, vetëm duhet të përcaktohet nga drejtori i DBF-së.

z.Avni Fetahu, drejtor i Drejtorisë së Arsimit, theksoi, kërkova fjalën vetëm për një sqarim në mënyrë që të mos dalim të hutuar nga kjo mbledhje, nuk qëndron ajo që u tha se mësimdhënës me 130 kredi sepse nuk ka, por është me 180 kredi.

Sa i përket notës mesatare mbi 9.2 që ka dal numri i studentëve, nuk e di saktë sa është numri por sigurisht jeni në dijeni ata që marrin bursë prej Universitetit të Shtetit janë me notën mesatare mbi 9.0, dhe nëse ka qenë rast social dhe ka aplikuar sigurisht se do t'i ndahej bursa, kush do qoftë ai student që u cekë, nuk po e di djali i kujt është por sigurisht që në çiftë se është brenda këtyre kriterëve ka mund të jetë përfitues i bursës, pra këto ishin vetëm sqarimet sa i përket pyetjeve që u parashtruan.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, nëse nuk ka diçka për të shtuar e hedhe në votim çështjen e parashtruar nga asamblisti z.Adnan Zymeri që t'i rekomandohet Komunës që të gjithë ata kandidatë, nxënës dhe studentë aplikues që i kanë plotësuar kushtet dhe kriteret sipas kësaj rregulloreje në fuqi, të vihen mjete buxhetore për realizimin e kërkesës së tyre.

z.Haki Rudari, theksoi, i dëshiroj mirëseardhje z.Blerim Maqastena dhe jam i lumtur që është në mesin e asamblistëve këtu. Sa i përket temës, të nderuar kolegë sidomos ju nga LDK-ja, pikërisht propozimi i fundit me shtyu që të marr fjalën ngase kjo tregon që kjo seancë është tipike politike, po e përsërisë e po e ri përsërisë, nuk ka ardhur LVV-ja me duar në gjepa dhe as nuk jemi në mandatin e kaluar të gjithë aplikantët të marrin bursën, Kryesuesi mund ta hedh në votim. Unë i kam 2 fëmijë student, si dhe 2 fëmijë tjerë në shkollën e mjekësisë dhe atë me të gjitha notat 5-she, nuk është problemi aty por problemi i gjendjes në arsim. Për diskutim për gjendjen në arsim në Komunën e Podujevës në parim e përkrahim sepse këtë gjendje e keni shkaktuar pikërisht ju LDK-ja. Profesori dhe Kryetari i Komunës z.Shpëtim Bulliqi ka rreth 5-6 muaj që e ka marr udhëheqjen e Komunës bashkë me kolegët nga LVV-ja dhe unë besoj që ndryshimet do të vijnë.

Çështje tjetër që mendoj që duhet të ngritët është edhe çështja e udhëheqjes së LDK-së për gjithë këtë mandat sa ka qenë, ndërsa se a e duam apo nuk e duam arsimin, nëse e keni dashur ju LDK-ja arsimin ju nuk keni qen mirë, nuk e ka sjell LVV-ja situatën e arsimit në këtë gjendje, LVV-ja e ka marr qeverisjen që 5-6 muaj, prandaj kjo tregon që është qellim tipik politik. Gjithashtu unë e kam parë që në mbledhjen e rregullt të radhës që është dërguar thirrja dhe materiali pikë e rendit të ditës siç e ceku drejtori i DKA-së, është edhe çështja e arsimit, pra pse kjo nguti që për një javë të pritët, prandaj e them se është politike por megjithatë aspekti politik është i qytetarit sepse qytetarët janë ata që tregojnë kush do ta fitojë prapë mandatin e udhëheqjes në 4 vitet e ardhshme. E vërtetë se më herët i kanë marr bursat të gjithë aplikuesit por kanë qenë 140,000.00€, por tani i keni lënë 50,000.00€ buxhet që Ekzekutivit t'i ndan bursa, por edhe kjo është meritë e LDK-së që prej 140,000€ sa i kanë pasur në mandatin e kaluar, tani në vitin 2021 i keni lënë 40,000.00€ - 50,000.00€ për ndarje të bursave, prandaj në këtë drejtim duhet të angazhohemi të gjithë.

Unë vijë nga fusha e arsimit që prej 30 vitesh, kam punuar për 10 vite dhe ndoshta ka koleg që ka punuar çdo ditë, kamë qenë anëtar i komisionit të arsimit për 4 vite mandatin e kaluar dhe në njëfarë

mënyre e kam udhëhequr gjithmonë atë komision dhe këtë e dinë kolegët që kanë qenë anëtar për arsye se duhet të punojnë të gjithë, por jo të bëhen gjëra vetëm për poteza politik sepse fundja fëmijët janë në studime dhe shkolla të mesme dhe nëse është një arsim i rendë dhe jo i mirë i përket fëmijëve të mi, me përket edhe mua që jam pjesë e arsimit prej 30 viteve dhe të gjithëve, prandaj tjetër është të bëjmë politik dhe tjetër është çështja të thirremi në ngritjen e cilësisë së arsimit, por jam për ta ngritur cilësinë e arsimit. Të nderur koleg, ai që e udhëheqë arsimin në Komunën e Podujevës është pjesë e ditarit një kohë të gjatë dhe të gjithë e dimë këtë, po besoj që herëve tjera është dashur dhe ka informata nëse doni më të sakta se si është bërë udhëheqja dhe në çfarë gjendje janë shkollat, vetëm një po dua t'ju them, tualetet në fshatin Shajkocë janë sikurse me qenë në Siri ose Afganistan, shkoni dhe vizitoni, për shkak të mungesës së ujit nxënësit për nevoja të tyre duhet të shkojnë në shtëpi kur kanë mundësi të shkojnë, ajo është gjendja në shkollën e fshatit Shajkofcit prandaj e them se duhet të mendohet.

LVV, në parim i përkrahë të gjitha subvencionet që bëhen në dobi të të gjithë aplikantëve, por është kundër thirrjes që të hedhet në votim për çështje politike, është kundër thirrjes që në emër të gjithë kësaj gjendje mundohen të fitojnë poena politik e në këtë drejtim ne si Grup do të dalim kundër.

Në parim, ndarjen subvencionimin për të gjithë sektorët e kemi me program qeverisës, qoftë në bujqësi, infrastrukturë etj, por si Grup i LVV jemi kundër ndarjes në baza politike dhe për qëllime politike.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, është propozimi i iniciuesit që t'i rekomandohet Ekzekutivit për shqyrtimin e të gjithë aplikantëve që i plotësojnë të gjitha kushtet dhe kriteret sipas rregulloreje funksionale, unë jam i detyruar që propozimin ta hedh në votim andaj votojmë.

znj.Lirika Maliqi, nga vendi pyet, a është propozim apo rekomandim.

Kryesuesi i Kuvendit, përgjigje parafolëses, ky është propozim përderisa të votohet.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se me 16 vota PËR, asnjë votë KUNDËR, dhe 11 vota të PËRMBAJTURA, miratohet rekomandimi, si në vijim.

Kuvendi i Komunës, i rekomandon Ekzekutivit të Komunës që;

-Të gjithë aplikantët, studentët dhe nxënësit që kanë aplikuar në konkursin për ndarjen e bursave për student dhe nxënës të shkollave të mesme për vitin akademik / shkollor 2020/2021, dhe që i plotësojnë kriteret në bazë të këtij konkursi, të jenë përfitues të bursave.

-Ekzekutivi i Komunës, konkretisht Drejtoria e Buxhetit dhe Financave të gjejë mundësitë buxhetore për këtë çështje.

- Për respektimin, përkatësisht zbatimin e këtij rekomandimi kujdeset Drejtoria e Buxhetit dhe Financave.

Meqë nuk pati të lajmëruar tjerë për të marrë fjalën, Kryesuesi i Kuvendit e konstatoi të përfunduar këtë mbledhje.

Mbledhja përfundoi në ora 11:55

Procesverbalin e mbajti

Enis Sheholli

Nr.01-060/04-0043158/21

Podujevë,

28 maj 2021

Kryesuesi i Kuvendit

Fatmir Gashi